



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development



PROGRAMI PËR BUJQËSI
DHE ZHVILLIM RURAL 2015

UDHËZUES PËR APLIKUES

MASA



UJITJA E TOKAVE BUJQËSORE



www.mbpzhr-ks.net

<http://azhb.rks-gov.net>



Ky dokument është përgatitur nga Autoriteti Menaxhues në Ministrinë e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë

Ky udhëzues shpërndahet falas

Tabela përmbajtjes

OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINANCIARE PËR KËTË MASË.....	4
Objektivat e masës.....	4
Objektivat e përgjithshme.....	4
Objektivat e veçanta.....	4
BUXHETI	5
PËRKUFIZIMET KRYESORE.....	6
SHKALLA E PERKRAHJES FINANCIARE DHE APLIKUESIT E PRANUESHËM	7
Shkalla e perkrahjes	7
Pranueshmëria e aplikuesve dhe aplikacioneve të tyre	7
SHPENZIMET E PRANUESHME	9
PROCEDURAT E APLIKIMIT	10
Përmbajta e aplikacionit	10
Kriteret e përzgjedhjes	10
DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I FUNDIT	12
PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI	12
Vlerësimet dhe zgjedhja e aplikacioneve; Procedurat e përzgjedhjes	12
Kontrollet në terren.....	13
Radhitja në listë	14
Vendimi i dhënies së grantit dhe Njoftimi i Aplikuesit.....	14
Ankesat.....	15
Pagesa e grantit.....	15
Monitorimi Ex-post.....	15
DISPOZITA TË RËNDËSISHME QË MUND TË JENË SHKAKTARË TË REFUZIMIT TË APLIKACIONIT.....	16
LISTA E SHTOJCAVE.....	17
SHTOJCA 1: LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA.....	18
SHTOJCA 2: FORMULARI PËR APLIKIM.....	20
SHTOJCA 3: PROJEKT PROPOZIMI	23
SHTOJCA 4: FORMULARI I KONTRATËS	24
SHTOJCA 5: PROCEDURAT E PROKURIMIT.....	29
Dispozitat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha llojet e blerjeve	29

Kriteret e dhënies/shpërblyese:.....	30
Kualifikimet e përgjithshme	31
Përshtatshmëria për detyrë	32
Përkufizimi i konfliktit të interesit.....	32
Procedurat e blerjes.....	33
Blerjet direkte deri në 10 000.00 euro.....	33
Përzgjedhja bazuar në të paktën 3 oferta duke u nisur prej 10 000.01 euro deri në 60 000.00 euro	33
Prokurimi me shpallje publike (tender i hapur) - duke filluar nga 30 000.01 deri në 60 000.00 euro	34
SHTOJCA 6: LISTA E INVESTIMEVE/SHPENZIMEVE TË PRANUESHME	35
SHTOJCA 7: FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË PËR MASËN UJITJE	36
SHTOJCA 8: LETRA INFORMUESE.....	41
SHTOJCA 9: FORMULARI I INDIKATORËVE.....	43
SHTOJCA 10: FORMA E ANKESËS.....	45
SHTOJCA 11: LISTA ME ADRESA TË ZYRAVE RAJONALE DHE KONTAKTET	46
AFATI I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT.....	47

OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINANCIARE PËR KËTË MASË

Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës, dhe ky zhvillim nuk mund të arrihet pa shfrytëzimin të arsyeshëm të pasurive ujore si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes. Derisa në stinët tjera të reshurat janë të mjaftueshme, gjatë stinës së verës ato mungojnë. Prandaj imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevoja të ujitjes së kulturave bimore.

Gjendja teknike e një pjese të madhe të infrastrukturës së ujitjes nuk është e mirë. Pendat, rezervarët e ujit, stacionet e ujitjes, pompat, kanalet, gypat etj. , kanë nevojë për rehabilitim, për ndërtime të reja si dhe për mirëmbajtje të rregullt. Zhvillimi i bujqësisë intensive dhe konkurruese, në kushtet ekonomisë së tregut të lirë, është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse merren parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit dhe për të ardhmen.

Objektivat e masës

Objektivat e përgjithshme

- Rritja e produktivitetit të prodhimeve bujqësore
- Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore.

Objektivat e veçanta

Modernizimi i sistemit për ujitje dhe kullimi, duke zvogëluar humbjet në sasinë e ujit. Përmirësimi i lidhjeve të brendshme në rrjetet ekzistuese të ujitjes.

BUXHETI

Sektorët	Vlera në €	% e buxhetit
Privatë (fermerët, shoqatat dhe ndërmarrje tjera bujqësore)	1,000,000	50%
Publikë (Komunat dhe kompanitë publike rajonale të ujitjes)	1,000,000	50%
Totali	2,000,000	100%

PËRKUFIZIMET KRYESORE

Shkalla e përkrahjes publike - është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme;

Aplikues - janë personat fizik ose personat juridik që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të prezantuara në këtë dokument dhe të cilët paraqesin kërkesë për të përfituar nga grandet e zhvillimit rural;

Aplikacion - dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;

Përfitues - personi fizik ose personi juridik i cili është deklaruar përfitues pas vlerësimit të aplikacionit dhe që ka nënshkruar kontratë me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;

Thirrja për aplikim - njoftimi publik për pranimin e aplikacioneve;

Kontrata - nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të aplikuesit të përzgjedhur dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë sipas modelit të përgatitur. Shih Shtojcën nr. 8.4.

Shpenzimet apo investimet e pranueshme - janë shpenzimet apo investimet që përkrahen me mjete publike. Shih Shtojcën nr. 8.6.

Periudha e monitorimit Ex-post - periudha kohore prej 5 vjetësh pas përfundimit të investimit, gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur dhe ka marrë pikë;

Grant - ndihma financiare e pakthyeshme e dhënë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për shpenzimet e pranueshme;

Autoriteti Menaxhues - entitet publik brenda MBPZHR-së i organizuar si Departament me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e Programit;

Masa - dokument teknik që paraqet njësinë bazë të Programit dhe pjesët kryesore të saj janë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikuesve. Masa ka buxhetin e saj përmes të cilit synohet të arrihet ndikim i caktuar. Masa zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve;

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është Agjenci e Pagesave (<http://azhb.rks-gov.net/>) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2015 - është dokument teknik i cili përcakton masat e zhvillimit rural, logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të granteve;

Projekt - investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikuesi;

Periudha e implementimit të projektit - koha prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB-ja;

Përzgjedhja - përcaktimi i numrit të pikëve për aplikuesit e pranueshëm, radhitja e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre "i përzgjedhur për financim" dhe shpërndarja e mjeteve financiare duke filluar nga ata në krye të listës.

SHKALLA E PERKRAHJES FINANCIARE DHE APLIKUESIT E PRANUESHËM

Shkalla e perkrahjes

- Përkrahja publike është 80% e shpenzimeve të pranueshme.

Pranueshmëria e aplikuesve dhe aplikacioneve të tyre

- Aplikuesit për këtë masë janë: komunat, kompanitë publike rajonale të ujitjes, shoqatat e ujitjes për bujqësi dhe fermeri si person fizik dhe person juridik.
- Të gjithë këta i nënshtrohen kontrollit të pranueshmërisë. Nëse konstatohet se aplikuesi është i papranueshëm, aplikacioni refuzohet. Pranueshmëria e aplikuesit kontrollohet në bazë të dokumenteve të kërkuara dhe atyre të dorëzuara.
- Një aplikues mund ta dorëzojë vetëm një projekt brenda vitit

- Aplikuesit duhet ta dorëzojnë aplikacionin mbështetur me të gjitha dokumentet e kërkuara. *Shih Shtojcën 1.*
- Aplikuesi duhet ta nënshkruajë një deklaratë që deklaron se ai/ajo nuk do të ndryshojë qëllimin e investimit për të paktën pesë vjet pas realizimit të investimit.
- Personat juridikë/përfituesit duhet gjithashtu të mbajnë investimet në kushte të përshtatshme. Aplikuesit nuk duhet të kenë detyrime të papaguara ndaj shtetit për sa i përket detyrimeve fiskale (taksat e ATK-së për personat juridikë) dhe nuk duhet të kenë obligime të pakryera financiare ndaj MBPZHR-së në bazë të marrëveshjeve kontraktuese.

Kujdes: Është e rëndësishme që taksat të paguhen gjatë zbatimit të Projektit dhe në periudhën e monitorimit Ex-post (5 vjet pas zbatimit të projektit). Përfituesit të cilët gjenden me taksat të papaguara gjatë afateve të përmendura, do të jenë të detyruar ta paguajnë të gjithë grantin e marrë, plus ndëshkimet e aplikueshme.

- Aplikuesi duhet të paraqesë një projekt-propozim sipas modelit të kërkuar. Vlera e investimit minimal në kuadër të kësaj mase është 30 000.00 euro dhe maksimalja e investimeve të pranueshme është 200 000.00 euro.
- Formulari i Treguesve duhet të plotësohet në mënyrë të drejtë. *Shih shtojcën 10.*

Në rast të projektit të ndërtimit apo rindërtimit, aplikuesi duhet t'i paraqesë edhe dokumentet në vazhdim:

- Kopja e skicave/dizajnimeve dhe vlerësimin e shpenzimeve për punën;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis (nëse para sheh ligji);
- Përgatitja e dokumenteve të aplikimit
- Të sillet projekti me dizajnim dhe paramasë nga shoqatat e ujitjes për bujqësi dhe fermeri si person fizik dhe juridik pasi të nënshkruhet kontrata.
- Me rastin e aplikimit të Komunave dhe Kompanive Publike të Ujitjes, aplikuesit duhet të paraqesin projektin detaj, me paramasë dhe parallogari.

Kujdes: Vendet e reja të deklaruara të punës duhet të regjistrohen, dhe taksat e tyre duhet të paguhen sipas ligjeve në fuqi!

SHPENZIMET E PRANUESHME

Rehabilitimi dhe vazhdimi i kanaleve dhe gypave të ujitjes;

Ndërtimi i rezervarëve të ujit;

Penda e ujitjes;

Ndërtimi i drenazhës/kullimit;

Pompat e ujitjes dhe pajisjet e tjera përcjellese: (pajisje për matjen e ujit, për rrymë etj.);

Rehabilitimi i pajisjeve (valvulat, lidhëset, gypat, përfshirë edhe punën)

Punët përcjellese me ndikim në mjedis, drenazhim (tarracat, nivelimi i tokës, varësisht nga lloji i projektit).

Shpenzimet që janë të lidhura me përgatitjet e projektit nuk mund ta kalojnë 3% të vlerës ndërsa në rast të investimeve që parashohin skica, dizajnimet të hollësishme, janë të pranueshme deri në 7%. Vlenë për Shoqatat e Ujitjes për bujqësi dhe fermerin si person fizik dhe juridik.

Skicat/dizajnimet e hollësishme të projektit inxhinierik

Vlerësimi i ndikimit mjedisor

Përgatitja e dokumenteve të aplikimit.

Hapja e puseve me kusht që pusi të ketë ujë

Këto shpenzime janë të pranueshme në mënyrë retroaktive vetëm për përfituesit përfundimtarë.

Kujdes: TVSH-ja është shpenzimi i papranueshëm dhe atë e paguan përfituesi! Edhe shpenzimet tjera të papranueshme do të paguhen nga përfituesi.

Çdo tentim për mashtrim (psh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit etj.), do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa.

PROCEDURAT E APLIKIMIT

Përmbajta e aplikacionit

Kujdes: Për të qenë i pranueshëm, aplikacioni duhet t'i përmbajë të gjitha dokumentet e radhitura në listën e paraqitur në Shtojcën nr. 8.2.

Në rastet kur kërkohen kopje të dokumenteve, dokumentet në origjinal duhet t'u prezantohen zyrtarëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesi duhet të shkruajë në kopje në këtë tekst: "si në origjinal", dhe ta nënshkruajë.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në zyrat rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Kriteret e përzgjedhjes

Kriteri	Parametri	Nr. i pikëve
Kostot efektive për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura	Metoda e kalkulimit: Të gjitha projektet teknike duhet të përfshijnë të dhëna në lidhje me zonën që është ndërtuar/rehabilituar/zgjeruar për ujitje dhe koston mesatare për hektar. Pasi të jenë vlerësuar të gjitha projektet, nga projektet e pranueshme do të krijohet një hierarki e kostove/ha, duke filluar nga më e ulëta deri tek më e larta. Projekti me koston më të ulët do ta marrë numrin maksimal të pikëve, ndërsa projekti me koston më të lartë për hektar do të marrin 0 (zero) pikë. Pjesa tjetër e projekteve të pranueshme do t'i marrë pikët (me 2 decimale) sipas këtij kriteri në bazë të kostos së tyre	Max . 30

	<p>për hektar, ndërsa rezultatet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë.</p> <p>Kalkulimi për poentim:</p> $30 * (C_p - \max C) / (\min C - \max C)$ <p>C_p - kosto për 1 ekstra ose hektar të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e vlerësuara.</p> <p>Shpenzime minimale C kosto për 1 ekstra hektar të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto minimale për ekstra ose hektar të modernizuar të ujitur.</p> <p>Maksimale C- kosto për 1 ekstra ose modernizim hektar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto maksimale për ekstra ose modernizim hektar të ujitur.</p>	
Sipërfaqja e ujitur (ha)	30-50	10
	50, 01 - 75, 00	15
	75, 01-100, 00	20
	100, 01 - 150, 00	25
	Më shumë se 150	30
Aplikuesi është Shoqatë për ujitjen e tokave bujqësore		10
Numri i fermerëve që përfitojnë nga projekti	Deri në 10	10
	11-20	15
	Më shumë se 20	20
Në fushën e projektit ka prodhues me projekte të miratuara nën masën	Deri në 5	5
	Më shumë se 5	10

101		
Totali		100

DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I FUNDIT

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur nga 25 shkurti deri më 10 prill 2015.

Aplikacionet së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara - *shih shtojcën: Lista e Dokumenteve të Dorëzuara* - duhet të dorëzohen brenda periudhës së përmendur në shpallje. Nëse aplikacioni nuk është i plotë, ai do të refuzohet menjëherë.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyrat Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI

Vlerësimet dhe zgjedhja e aplikacioneve; Procedurat e përzgjedhjes

Procedura e përzgjedhjes do të bazohet në një sistem të renditjes së kritereve të përzgjedhjes, e cila do të zhvillohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si pjesë e thirrjes publike për aplikim për përzgjedhjen e masës së ujitjes!

Projekti teknik i dorëzuar duhet ta demonstrojë zvogëlimin e humbjeve të ujit në minimum 10% në rast modernizimi.

Punëkryesi duhet të garantojë dhe të mirëmbajë ose të bëjë riparimin e infrastrukturës bujqësore të paktën 3 vjet pas zbatimit të projektit dhe të jetë nën kontrollin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Departamentit të PBT së MPBRZH-së. Nëse nuk është bërë mirëmbajtja gjatë kësaj periudhe, atëherë përfituesi duhet ta kthejë prapa investimin.

Vetëm në rast të fatkeqësive natyrore, atëherë duhet të formohet një komision nga AZHB-ja dhe MBPZHR-ja dhe me raportin e komisionit konstatohet se prishja e projektit është bërë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, atëherë punëkryesi nuk ka obligim ta garantojë punën që e ka kryer sipas kontratës.

Për kryerjen e punimeve për projektin nga shoqatat e ujitjes për bujqësi, dhe fermeri si person fizik dhe juridik, duhet të kontraktohet ndërtuesi i cili ka përvojë të mëhershme në ndërtimet relevante që kërkohen, dhe i cili do të garantojë për punën e ndërtimit për së paku 3 vjet pas finalizimit të punës. Ndërtuesi i kontraktuar duhet të dëshmojë fitimin e ndërmarrjes së tij për tri vitet e fundit dhe respektimin e rregullave të legjislacionit nacional të prokurimit.

Përfituesi duhet ta dorëzojë deklaratën me shkrim për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit.

Sipërfaqja minimale e projektit nën ujitje duhet të jetë 30 hektarë.

Aplikuesi duhet t'i dëshmojë të drejtat pronësore lidhur me investimin e propozuar.

Një kompani e ujitjes, Komuna, Shoqata e përdoruesve të ujit dhe Fermeri si person fizik ose juridik, mund të aplikojë maksimumi 1 projekt brenda një viti.

Aplikuesit do ta paraqesin vendimin pozitiv të Bordit/Kuvendit gjatë propozimit të investimit ku do të sigurohet 20% nga përfituesi.

Vlerësimi i projekteve dhe kontrollet në terren do të bëhen nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe nga Departamenti i PBT së MPBRZH-së para dhe pas nënshkrimit të kontratës.

Kosto minimale e investimit të pranueshëm për projekt është 30 000.00 €.

Kontrollet në terren

Së paku janë tri kontrolle të parapara në terren: para së të nënshkruhet Kontrata, para se të deklarohet Pagesa për t'u bërë, AZHB është e obliguar që ta marrë një ekspert hidroinxhinier në mënyrë që të bëhet vlerësimi i projektit sa më i saktë, deri 5 vjet pas implementimit të Projektit – gjatë Periudhës së Monitorimit ex-post të Projektit.

Kujdes: Kur ka kërkesë për kontroll, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në investimet e bëra. Kjo vlen po ashtu edhe nëse kërkohet ndonjë dokument shtesë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodh mosrespektimi i këtij kushti, duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i grantit dhe ndëshkimi i aplikuesit!

Radhitja në listë

Të gjitha projektet e pranuar duhet të radhiten në bazë të poenëve të pranuar. Shpërndarja financiare e Thirrjes për Propozime duhet të bëhet bazuar në aplikacione me poenë më të lartë. Rezultati i radhitjes do të postohet në uebfaqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (azhb.rks-gov.net) nëpërmes së cilës po ashtu aplikuesit ftohen që t'i nënshkruajnë kontratat.

Vendimi i dhënies së grantit dhe Njoftimi i Aplikuesit

Pas vlerësimit, AZHB-ja përgatit Raportin e Vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në: 1) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë) dhe 2) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë. Ky raport nënshkruhet nga shefi i Agjencisë, brenda 24 orëve publikohet në web-faqen e AZHB-së dhe brenda 7 ditëve aplikuesi duhet ta marrë letrën informuese me rezultatin e vlerësimit të projektit të tij. Në rastet kur projekti është i papranueshëm ose nuk ka marrë pikë në disa kritere, arsyet për këtë duhet të paraqiten në letrën Informuese.

Ankesat

- Prej dites së pranimit të letrës informuese, aplikanti ka afat 5 ditë të ushtroj ankesë, në zyrën ku edhe e ka dorëzuar aplikacionin. Ankesës duhet t'i bashkangjitet një kopje e letrës informuese dhe nëse ka edhe ndonjë dokument tjetër.
- AZHB duhet t'i shqyrtoj ankesat dhe tu kthej përgjigjeje aplikuseve në aftë prej 10 ditësh. aplikantët duhet të marrin përgjigjeje nga komisioni i ankesave me rezultat të vlerësimit dhe nëse ankesa e tyre është refuzuar, edhe arsyet e refuzimit.

Pagesa e grantit

Per entitetet private (fermeret dhe ndermarrjet tjera bujqesore) pagesa për masën e ujitjes se tokave bujqesore bëhet në dy këste; pjesa e parë e përkrahjes publike në shumë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin dhe pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet me të përfunduar të investimit të përgjithshëm.

Kur është përfitues Komuna ose Kompani publike e ujitjes, pagesa do të bëhet sipas Ligjit të prokurimit publik **Nr. 04/L-042**.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 euro duhet të bëhen përmes transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 euro duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

Monitorimi Ex-post

Të gjitha projektet do të monitorohen 5 vjet pas implementimit të projektit. Kontrollimi do të bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Qëllimi i investimit duhet të ruhet edhe 5 vjet pas investimit. Gjithashtu, përfituesit duhet të vazhdojnë t'i respektojnë të gjitha kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes për të cilat

aplikuesit janë poentuar. Nëse ndodh shkelja e këtyre rregullave, atëherë do të kthehet granti dhe përfituesi do të ndëshkohet me pagesë.

DISPOZITA TË RËNDËSISHME QË MUND TË JENË SHKAKTARË TË REFUZIMIT TË APLIKACIONIT

Aplikacionet mund të refuzohen nëse nuk janë të kompletuara, nëse nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë ose edhe kur e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë mund të refuzohen për shkak të numrit të vogël të pikëve.

Kujdes: arsyet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në letrën informuese të cilën Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ia dërgon aplikuesit.

- Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në momentin e verifikimit nga zyrtari i AZHB-së me rastin e dorëzimit të tyre. Në rast se konstatohet më vonë se aplikacioni nuk është i kompletuar, ai po ashtu refuzohet.
- Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme gjatë procesit të vlerësimit të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë. Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrollit administrativ (psh. mospërputhje me të dhënat apo vlerësime të dokumenteve ose gjatë kontrollit në terren. Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve.

Kujdes: Për aplikacionet e pakompletuara aplikuesi njoftohet menjëherë. Aplikacionet e papranueshme dhe ato të pranueshme por me numër të vogël të pikëve, janë pjesë e Raportit të Vlerësimit të cilin Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e publikon në uebfaqen zyrtare (azhb.rks-gov.net) jo më vonë se 24 orë pasi që lista e aplikuesve është e përfunduar dhe nënshkruar nga shefi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesit duhet të njoftohen me shkrim me rezultatin e vlerësimit më së largu pesë ditë pas shpalljes së listës në web-faqe.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Lista e dokumenteve të dorëzuara;

Shtojca 2: Formulari për Aplikim;

Shtojca 3: Projekt-Propozimi;

Shtojca 4: Formulari i Kontratës;

Shtojca 5: Procedurat e prokurimit;

Shtojca 6: Lista e Investimeve/Shpenzimeve të Pranueshme;

Shtojca 7: Formulari i Kërkesës për Pagesë për Masën e Ujitjes;

Shtojca 8: Letra Informuese;

Shtojca 9: Formulari i Indikatorëve;

Shtojca 10: Forma e Ankesës;

Shtojca 11: Lista me adresa të Zyrave Rajonale dhe Detajet e Kontakteve;

Shtojca 12: Afati për implementim të projektit.

SHTOJCA 1: LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

Dokumentet e kompletuara (dosja) duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e mëposhtme dhe çdo faqe duhet ta ketë të shkruar numrin (me dorë). Ky numër duhet të paraqitet në listë pranë emrit të dokumentit.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti të detyrueshëm, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikuesin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce, duke ia rrumbullakuar dokumentet që i mungojnë. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që t'i kompletojë dokumentet.

Në rastet kur kërkohet vetëm kopje e dokumentit, aplikuesi e shkruan me dorë në kopje “**sikur në origjinal**” dhe ia sjell origjinalin në shikim zyrtarit rajonal i cili verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ia kthen origjinalin aplikuesit.

Nr.	DOKUMENTI	Obligati	Opciona
1.	FORMULARI PËR APLIKIM Sipas modelit të AZHB-së, i plotësuar me makinë ose kompjuter (nuk lejohet dorëshkrimi) Kontrolli nëse dokumentet janë të mbushura si duhet të bëhet në momentin e dorëzimit në prani të aplikuesit	f. <input type="checkbox"/>	
2.	FORMULARI PËR INDIKATOR I PLOTËSUAR (NË ORIGJINAL) Në prani të aplikuesit zyrtari verifikon nëse është plotësuar si duhet formulari për indikatorët.	f. —	
3.	LLOGARIA RRJEDHËSE , dokument i lëshuar dhe vulosur nga banka (në origjinal). Llogaria rrjedhëse duhet të jetë nga një bankë që operon në Kosovë	f. <input type="checkbox"/>	
4.	Në rastin e personave juridikë: CERTIFIKATA E NUMRIT FISKAL - kopje	f. <input type="checkbox"/>	
5.	PROJEKTI TEKNIK (me llogaritje për ta zvogëluar sasinë e ujit që humbet në rast të projekteve për modernizim dhe projektimet relevante) - në origjinal	f. <input type="checkbox"/>	

	Në rastet e aplikimit të Komunave dhe Kompanive Publike të Ujitjes, aplikuesit duhet të paraqesin projektin detaj, me paramasë dhe parallogarit	F — <input type="checkbox"/>	
6.	Lista e fermerëve që përfitojnë nga sistemi i ujitjes së propozuar që të ndërtohet/modernizohet/zgjerohet bashkë me NIF e tyre (nga Regjistri i Fermës) dhe zonën e tyre (me ndarje në: 1. zonën për hortikulturë dhe 2. zona të tjera bujqësore) të cilat do të përfitojnë direkt nga realizimi i projektit (në ha) - në origjinal	f. — <input type="checkbox"/>	
7.	Për personat juridikë: VËRTETIM nga Administrata Tatimore e Kosovës që dëshmon se aplikuesi nuk ka obligime të papaguara (në origjinal)	f. — <input type="checkbox"/>	
8.	AUTORIZIMI - Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri.	f. <input type="checkbox"/>	
9.	DOKUMENTI që dëshmon pronësinë mbi tokën ku do të kryhet investimi	f. <input type="checkbox"/> —	
10.	NË RAST TË KOMUNËS: Vendimi i Kuvendit për Projektin Teknik NË RAST TË KOMPANISË SË UJËSJELLËSIT: Vendimi i Bordit për Projektin Teknik	f. — <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	
11.	Projekti detaj me paramasë dhe parallogari duhet të paraqitet nga Komunitat dhe Kompanitë Publike të Ujitjes	f. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	

SHTOJCA 2: FORMULARI PËR APLIKIM

FORMULARI PËR APLIKIM MASA - Ujitja e tokave bujqësore – 2015																					
I. Emri i aplikuesit (Emri, Emri i babës, Mbiemri ose Subjekti juridik)																				
Numri Personal	<table border="1" style="width: 100%; height: 20px; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> </tr> </table>																				
Nr. i kartës së Identifikimit	<table border="1" style="width: 100%; height: 20px; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> <td style="width: 12.5%;"></td> </tr> </table>																				
Komuna:																					
Vendbanimi:																					
Adresa:																					
Telefoni:																					
E-mail:																					
Uebfaqja:																					
Statusi Juridik:	Person fizik <input type="checkbox"/> Subjekt juridik <input type="checkbox"/>																				
II. Emri i projektit	_____ _____ _____																				
<i>Vetëm për përdorim zyrtar (të plotësohet nga shërbyesi zyrtari rajonal):</i>																					
Numri unik regjistruar i projektit (NUR): _____																					
III. Data:	_____ (dd/mm/vvvv)																				
IV. Koha:	_____ (ora dhe minuta, të plotësohet vetëm kur aplikacioni të jetë kompletuar)																				

V. Aplikacioni është kompletuar	<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO
---------------------------------	---

(Emri, Mbiemri dhe nënshkrimi i përfituesit)

(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i zyrtarit)

VI. Numri (NIF) nga Regjistri i Fermës:		<input type="text"/>
VII. Për personat juridikë - Numri Regjistruar i Biznesit:		<input type="text"/>
VIII. Për të gjithë aplikuesit:		
Banka	Emri i bankës:	
	IBAN:	
	Nr. i Llogarisë rrjedhëse:	<input type="text"/>
	Adresa:	
IX. Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri i cili dorëzohet në origjinal, dhe të autorizuarit i merren të dhënat e mëposhtme		
Emri	Numri personal	<input type="text"/>
_____	Nr. i kartës së identifikimit	<input type="text"/>
Emri i Babës	E-mail:	_____
Mbiemri	_____	
X. Deklaratat		
Unë deklaroj se sipërfaqja e ujitur e përfshirë nga sistemi i ujitjes që është paraparë të modernizohet /zgjerohet është (së paku 30 hektarë) - siç është prezantuar në dokumentin nr. 9 të bashkëngjitur		

Unë deklaroj bazuar në të dhëna ekzistuese mbi Regjistrin e Fermës për vitin 2015, fermat të cilat do të përfitojnë nga sistemi i ujitjes që është paraparë që të modernizohet/zgjerohet dhe me dokumentin nr. 9 të bashkangjitur (të kontrollohet nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë)	50% e këtyre sipërfaqeve të fermave është e dedikuar për hortikulturë - tokë (jo të punueshme)	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
	30% e këtyre sipërfaqeve është e dedikuar për hortikulturë - tokë (jo të punueshme)	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo

Numri i fermave/fermerëve që të do të përfitojë nga sistemi i ujitjes i paraparë që të modernizohet/ zgjerohet është _____, siç është paraqitur në dokumentin nr. 9 të bashkëngjitur.

XI. Zotimet

Unë do të angazhohem për të siguruar bashkëfinancimin (20% të kostove të pranueshme) dhe kostot jo të pranueshme të projektit.

Unë do të angazhohem për të mirëmbajtur/riparuar/infrastrukturën e zgjeruar dhe të modernizuar për të paktën 3 vjet pas zbatimit të projektit, duke qenë i vetëdijshëm se në qoftë se dështon atëherë unë duhet ta kthej përkrahjen e marrë, plus gjobat - në bazë të legjislacionit kombëtar.

Unë angazhohen të kontraktoj (sipas legjislacionin kombëtar të Prokurimit) një ndërtues i cili:

- Mund të dëshmojë përvojën relevante;
- Do të garantojë për ndërtimin e bërë për të paktën 3 vjet;
- Do të demonstrojnë fitimin e kompanisë për 3 vitet e fundit

XII. Data / Nënshkrimi

